



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 12 maj 2011  
Nr. ref.: 104 /11

## **SQARIM**

i

## **AKTGJYKIMIT**

në

**Rastin Nr. KI 08/09**

**Sindikata e pavarur e punonjësve të Fabrikës së Çelikut IMK Ferizaj, e  
përfaqësuar nga z. Ali Azemi, kryetar i Sindikatës**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajt, C  
Nr. 340/2001, të 11 janarit 2002**

**Sqarimi i kërkuar për Aktgjykimin e 17 dhjetorit 2010**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Objekti i çështjes**

1. Kërkesë për sqarim, dorëzuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

## **Baza juridike**

2. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56 (1) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

3. Më 31 mars 2011, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) mbajti një seancë për të vlerësuar dhe vendosur për kërkesën e mësipërme.

## **Faktet**

4. Më 18 janar 2011, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës mori një kërkesë për sqarim nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), që përmbante dy pyetje lidhur me Aktgjykimin e kësaj Gjykate për Rastin KI-08/09, të miratuar më 17 dhjetor 2010, në të cilën thuhet:

“ ...

1. *Fëllimisht, AKP kërkon sqarim lidhur me pjesën e parë të pikës III të dispozitivit, se cili vendim cilësohet si final dhe i detyrueshëm - res judicata, duke specifikuar numrin e lëndës dhe datën e lëshimit të vendimit që është subjekt i këtij dispozitivi.*
2. *Së dyti, në funksion të zbatimit të këtij aktgjykimi, AKP kërkon të sqarohet cilat janë detyrimet konkrete të AKP-së për zbatimin e pjesë së dytë të pikës III të dispozitivit. Sidomos duke pasur parasysh dispozitat ligjore të Rregullores Nr. 2005/48 mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve nën Autoritetin Administrativ të AKP-së, si pasardhëse ligjore e ish-Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.*

...”

## **Kufijtë ligjorë për vlerësimin e kërkesës**

5. Gjykata u përgjigjet pyetjeve të parashtruara më lart duke pasur parasysh bazën e sipërpërmendur juridike, bashkë me legjitimitetin, rëndësinë dhe relevancën e kërkesës dhe kufijtë e objektit të çështjes së petitimit, që është në bazë të aktgjykimit të nxjerrë në këtë rast.
6. Prandaj, duke pasur parasysh që Gjykata u përmbahet kufijve të aktgjykimit të vet dhe ligjërisht nuk është e autorizuar të dalë përtej atyre kufijve, pyetjet sqarohen me sa vijon.

## **Përgjigja në kërkesë**

7. Sa i përket pyetjes së parë, se cili vendim cilësohet si final dhe i detyrueshëm - *res judicata* – që është subjekt i pikës III, përgjigja është se vendimi në fjalë përmendet disa herë në këtë Aktgjykim. Pavarësisht nga kjo, vendimi në fjalë është: Vendimi i Gjykatës Komunale të Ferizajt, C. Nr. 340/2011, i 11 janarit 2002.
8. Sa i përket pyetjes së dytë, e cila ka të bëjë me detyrimet konkrete të AKP-së për zbatimin e pikës III lidhur me Rregulloren Nr. 2005/48 mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve nën Autoritetin Administrativ të AKP-së, përgjigja është se Aktgjykimi nuk e shfuqizon Ligjin Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare apo ndonjë ligj tjetër.


9. Rasti ka të bëjë me vendimin *res judicata* të Gjykatës Komunale, i cili ende nuk është zbatuar as pas nëntë vjetësh, kurse përkundër vendimit *res judicata*, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) e privatizoi debitorin IMK. Duke dështuar për një periudhë kaq të gjatë kohore në zbatimin e Aktgjykimit të 11 janarit 2002, autoritetet e dhura ua kanë privuar dispozitave të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 dhe 13 të KEDNj-së gjithë efektin e tyre të dobishëm, siç ceket në Aktgjykim. Si rrjedhojë, Gjykata konsideroi që vendimi final dhe i detyrueshëm i Gjykatës Komunale të Ferizajt duhet të ekzekutohet.
10. Veç kësaj, sipas Ligjit për AKP-në, duket që AKP-ja është autoriteti që administron ndërmarrjet shoqërore dhe që AKP-ja do t'i përmbushë pretendimet e vlefshme të kreditorëve që kanë të bëjnë me ndërmarrjet shoqërore nga mjetet e realizuara nga administrimi, shitja, transferimi ose likuidimi i ndërmarrjeve dhe/ose aseteve të tilla. Pasi këto mjete të realizuara mbahen në mirëbesim dhe në të mirë të kreditorëve përkatës nga AKP-ja, AKP-ja mund të jetë e vetmja dhe tërësisht përgjegjëse për zbatimin e Vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajt, C. Nr. 340/2001, të 11 janarit 2002, varësisht nëse dhe në çfarë mënyre paraardhësja e saj AKM-ja, veprimi gjatë këtyre nëntë vjetëve të fundit lidhur me aktgjykimin e gjykatës komunale dhe respektimin e ligjit të zbatueshëm.
11. Në emër të Gjykatës, e cila është përgjegjëse për interpretimin e Kushtetutës, por që nuk është autoriteti përfundimtar për përcaktimin e ligjshmërisë së një statuti, Gjykata i paralajmëron palët përgjegjëse në Rastin KI-08/09 që ta kërkojnë këshillën e vet juridike lidhur me përgjegjësinë ligjore të Qeverisë dhe të AKP-së.

#### **PËR KËTO ARSYE**


GJYKATA, më 12 maj 2011, vendos, njëzëri të japë sqarime në pyetjet e kërkuara si më sipër.

Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me Nenin 20 (4) të Ligjit.

**Gjyqtari Raportues**



Altay Suroy



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. Dr. Enver Hasani